



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Mars 2022

Nr: 115

**VENDIM**

**PËR**

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 54, QARKU FIER DHE TË KZAZ NR. 22, QARKU DURRËS**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 1351 prot., datë 2.3.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr. 54, qarku Fier.

Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 1353 prot., datë 2.3.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr. 22, qarku Durrës.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



## VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin (kryetarin) e KZAZ nr. 22, z. Klajdi Koseni, qarku Durrës dhe anëtarin (zëvendëskryetarin) e KZAZ nr. 54, z. Roland Ziu, qarku Fier.
2. Të emërojë anëtarin (kryetarin) e KZAZ nr. 22, z. Halil Maksuti, qarku Durrës dhe anëtarin (zëvendëskryetarin) e KZAZ nr. 54, z. Evis Qyra, qarku Fier.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

